LIGJ
Nr.9985, datë 11.9.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7952, DATË 21.6.1995 "PËR SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Kudo në ligj fjalët "arsim i detyruar" zëvendësohen me fjalët "arsim bazë".

Neni 2

Kudo në ligj fjalët "shkollat e mesme të përgjithshme" zëvendësohen me fjalën "gjimnaze".

Neni 3

Në nenin 8, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:
"Të gjithë fëmijët e moshës 6-vjeçare në Republikën e Shqipërisë duhet të fillojnë arsimin bazë, i cili zgjat jo më pak se 9 vjet.".

Neni 4

Në nenin 20, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:
"Arsimi bazë është arsimi i detyruar dhe i njësuar.".

Neni 5

Në nenin 30 pika 30.1, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:
"Afati i këtyre shkollave është 3 vjet.".

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5889, datë 17.9.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi